



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4380/1 Prot

Tiranë, më 29.06 2022

U D H Ë Z I M

Nr. 16, datë 29.06 2022

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Në kreun I të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

- i. Në fund të shkronjës "a" të pikës 1 të shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*".
- ii. Në shkronjën "b" të pikës 2, në shkronjat "a" dhe "c" të pikës 3 dhe në pikën 4, mbas togfjalëshit "*maturantëve/kandidatëve*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*".
- iii. Në fund të pikës 5 shtohet togfjalëshi "*ndërsa për kandidatët nga Republika e Kosovës hedhja e rezultateve bëhet nga institucioni arsimor parauniversitar, i përcaktuar nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, pas njohjes dhe njehsimit të rezultateve nga QSHA-ja.*".

b) Në kreun II të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

- i. Në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të shkronjës A mbas togfjalëshit "*maturantët/kandidatët*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*".
- ii. Pas pikës 2 të shkronjës A, shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:
"*2/1. Përyjashtimisht, maturantët/kandidatët, përfshirë kandidatët nga Kosova, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, me notë mesatare minimale për pranim mund të aplikojnë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, duke konfirmuar në rubrikat*

e aplikimit dakordësinë për mosndjekjen e këtyre programeve në ciklin e dytë dhe pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas, programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë.”.

- iii. Në titullin e shkronjës B, si dhe në pikën 1 të shkronjës B, pas togfjalëshit “*maturantëve/kandidatëve*” shtohet togfjalëshi “*përfshirë kandidatët nga Kosova*”.
- iv. Në pikën 5 të shkronjës C pas togfjalëshit “*Maturantët/kandidatët*” shtohet togfjalëshi “*përfshirë kandidatët nga Kosova*”. Gjithashtu në pikën 9 të shkronjës C togfjalëshi “*fillimit të aplikimit për regjistrim*” zëvendësohet me togfjalëshin “*përfundimit të afatit për çregjistrim*” dhe togfjalëshi “*raundin e dytë*” zëvendësohet me togfjalëshin “*raundin e parë*”.
- v. Në pikën 4/1 të shkronjës E togfjalëshi “*fillimit të aplikimit për regjistrim*” zëvendësohet me togfjalëshin “*përfundimit të afatit për çregjistrim*”.

c) Pas pikës 7 të shkronjës G të kreut III, shtohen pikat 7/1 dhe 7/2 me përmbajtje si më poshtë:

“7/1. Pas përfundimit të raundit të tretë, kandidatët që janë pjesë e portalit U-albania dhe rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të pa paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e përfundimit të raundit të tretë.

7/2. Studentët të cilët pas përfundimit të raundit të tretë, rezultojnë të regjistruar në një program studimi ku nuk plotësohet numri minimal i parashikuar në aktet e brendshme të IAL-ve për aktivizimin e programit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve me vendim të Senatit Akademik bëhet kalimi në program studimi të përzgjedhur prej studentit, ku ka kuota të paplotësuara. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA-së për të vijuar procedurën e regjistrimit dhe matrikullimit.”.

d) Në kreun IV/3 të udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

- i. Titulli ndryshohet “*Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë*”.
- ii. Në pikën 1 togfjalëshi “*kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it*” zëvendësohet me togfjalëshin “*afateve të përcaktuara nga vet IAL-të*”.
- iii. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:
“2.1 Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar dhe

pajis me numër matrikullimi studentin, si dhe brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it dhe ia komunikon IAL-së.”.

iv. Pas pikës 5 shtohen pikat 5.1 dhe 5.2 me përmbajtje si më poshtë:

“5.1 Kandidatët paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.

5.2 Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.”

v. Pika 11 ndryshon si më poshtë:

“11. IAL-të, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatëve të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10-ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL-ja.”.

vi. Pika 12 ndryshon si më poshtë:

“12. Sekretaritetë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.”.

vii. Pika 13 shfuqizohet.

e) Në kreun IV/4 të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarëve mësimore të njësisve kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.”.

ii. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Brenda afateve IAL-të publike dhe jopublike, afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisve kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike

zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.”.

iii. Në pikën 4 hiqet togfjalëshi “...në Portalin U-Albania, përkatësisht deri...”.

iv. Në pikën 5 hiqet togfjalëshi “...në Portalin U-Albania...”.

v. Në pikën 13 hiqet togfjalëshi “...në Portalin U-Albania dhe...”.

vi. Pika 18 shfuqizohet.

f) Në kreun V të udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

i. Kudo në pikën 1 në fund të togfjalëshit “sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”” shtohet termi “i ndryshuar”.

ii. Pas shkronjës “g” të pikës 1 shtohet shkronja “gj” me përmbajtje si më poshtë:

“gj) brenda datës 30 maj të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, “Dokoratë”, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar”.

iii. Në pikën 3 togfjalëshi “sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”” zëvendësohet me togfjalëshin “sipas udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar”.

iv. Në pikën 4 termi “janar” zëvendësohet me termin “qershor”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

EVIS KUSHI

